



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 50, datë 28.02.2023

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 248, DATË 10.04.2015 “PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË PËRFITUESVE PËR NDARJEN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA ME STRUKTURË 2+1 DHE 1+1”, SEKSIONI I, I NDRYSHUAR

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet, që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.574, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 248, datë 10.04.2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e listës emërore të përfituesve për ndarjen e banesave sociale me qira me strukturë 2+1 dhe 1+1”, Seksioni I, lagjja nr. 17, rruga “Dalip Peza”, i ndryshuar si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Komisioni i Strehimit si dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të listës emërore të familjeve përfituese nga banesat sociale me qira me strukturë 2+1 dhe 1+1, Seksioni I, lagjja nr. 17, rruga “Dalip Peza”, i ndryshuar miratuar

me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 248, datë 10.04.2015, sipas listës bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij vendimi si më poshtë:

- a. Ndryshimin e emrit të qiramarrësit për shkak të ndarjes nga jeta të z. Riza Maliq Lufo në znj. Fetije Qamil Lufo në bazë të çertifikatës familjare datë 30.09.2022 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile si kryefamiljare, nuk kemi ndryshime të tjera në përbërjen familjare. Qiramarrësi përmbush të gjitha kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm për të qënë përfitues.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 02.03.2023

“Për ndryshimin e VKB-së nr.248 datë 10.04.2015 ”Për shqyrtimin dhe miratimin e listës emërore të fituesve për ndarjen e banesave sociale me qera me strukturë 2+1 dhe 1+1” Seksioni I

Nr.	Emer Mbiemer	Seksioni	Kati	Hyrja	Sip.	Strukturra	VI e Qerase	Shënime (jeton me qera)
1	Riza Maliq Lufo (vdekur)	A1	3	2	100.31	2+1	9700	Fetije Qamil Lufo

Përfundon me numrin rendor një





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 166 prot.
6

Durrës, më 13 03 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**



**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.50 datë 28.02.2023 “Për miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 248, datë 10.04.2015 “Për shqyrtimin dhe miratimin e listës emërore të përfituesve për ndarjen e banesave sociale me qira me strukturë 2+1 dhe 1+1”, seksioni I, i ndryshuar”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

